



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2019:164104

Datë: 18.09.2024

Numri i dokumentit: 06178714

**C.nr.533/16**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti I Përgjithshëm, Divizioni Civil**, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtarin Binak Duqi dhe procesmbajtësen Fexhrije Sejdiu, duke vendosur në çështjen civile - juridike të paditësit Sh. (R.) M. nga P. rr."S. S.", p/n, te cilin sipas autorizimit i përfaqëson djali tij A. Sh. M. nga P., kundër të paditurve: 1. P. (Xh.) K. ish nga fshati Ll. e E. K. P. dhe 2. B. (M.) D. ish nga fshati Ll. e E. K. P., tani qe te dy me vendbanim të panjohur diku në S., të cilet i përfaqëson përfaqësuesja e përkohshëm av. E. M., nga P., rr."N. G.", p/n, sipas padisë për vërtetim pronësie, në shqyrtimin kryesor, publik, të mbajtur me dt.12.09.2024., në prani të autorizuarit te paditësit dhe, te përfaqësueses së përkohshme e të paditurve, ndërsa me datë 18.09.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET, tërësisht padia dhe** kërkesëpadia e paditësit: Sh. (R.) M. nga P., SI E BAZUAR dhe

**II. Detyrohen** te paditurit: 1. P. (Xh.) K. dhe 2. B. (M.) D. ish nga fshati Ll. e E. K. P., tani qe te dy me adresë dhe vendbanim të panjohur diku në S., **qe** paditësit t'ia njohin të drejtën e pronësisë te cilën te drejte e ka fituar ne baze te kontratës gojore te shitblerjes dhe ne baze te posedimit me mirëbesim- parashkrim fitues) dhe atë:

Në ngastrat kadastrale nr. ..., prone private, lloj i njësisë parcele, me kulturë toke bujqësore, are e kl. ... dhe atë nga sipërfaqja e përgjithshme e ngastrës kadastrale, prej ... m katrore, ku paditësit i njihet e drejta e pronësisë ne një pjese te saj ne sipërfaqen prej ... m katrore, te evidentuar ne emër dhe pronar P. (Xh.) K. e cila gjendet ne vendin e quajtur "T. P.-F. (Apo K. P.-F.)" ZK. Ll. e P., ne ... te saj, dhe ngastrës kadastrale nr.; ..., prone private, me kulture are, kl. ... , nga sipërfaqja e përgjithshme e saj qe ka prej .. m katrore, paditësit i njihet e drejta e pronësisë, ne një pjese te saj, ne sipërfaqen prej ... m katrore, e evidentuar ne certifikatën e pronësisë ne emër te paditurit B. (M.) D. ish nga Ll. e e E. K. P., e cila gjendet ne vendin e quajtur "T. P.-F." ZK. Ll. e P., ne posedim dhe pronar i ... te saj.

**III. DETYROHEN** te paditurit qe t'ia njohin të drejtën e pronës paditësit ne paluajtshmerine e përshkruar si ne piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe të lejojnë qe kjo e drejtë e paluajtshme risë të regjistrohet në regjistrin për regjistrimin e të drejtave në paluajtshmëri në

DKGJP-ZKK në P., ne emër te paditësit Sh. (R.) M. nga P., ne afatin prej 15 ditësh, pas pranimit te këtij aktgjykimi, nen kërcenim te përmbarimit me dhune.

**IV.** Ky aktgjykim do ti shërbej Drejtorisë Për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi (DKGJP) K. P. që ti bëjë ndryshimet e duhura dhe t'ia lejoj qe kjo e drejte te regjistrohet ne regjistrin për regjistrimin e te drejtave ne paluajtshmeri, pranë DKGJP-ZKK. P..

**V.** Detyrohet paditësi qe ne emër te taksës gjyqësore shtese te paguaje shumen prej 45.00 euro, ne llogarinë e kësaj gjykate, ne afat prej 15 ditësh , pas pranimit te këtij aktgjykimi, nen kërcenim te përmbarimit me dhune.

**VI.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

### **A r s y e t i m**

Paditësi Sh. R. M. nga P. ka ushtruar padi pranë kësaj gjykate me dt. 13.12.2016, kundër të paditurve P. (Xh.) K. dhe B. (M.) D. qe te dy nga ish nga fshati Ll. e E. K. P. tani me vendbanim të panjohur diku në S., për vërtetimin e pronësisë në bazë të kontratës së lidhur jo formale me goje për shitblerjen e paluajtshmërisë te vitit 1975. Ne mes te paditësit- babait te ti babai i te dhe gjyshi i tij qe janë paraardhësit e te autorizuarit A. si dhe vet te paditurive. Të ngastrave kadastrale nr. ... dhe ... te precizuara gjate seancës. Ngastra kad. nr. ... ka sipërfaqe te përgjithshme prej ... m katrore, ndërsa kërkon njohjen e pronësisë për pjesën e saj prej ... m katrore dhe ngastra nr. ... ka sipërfaqe prej ... m katrore, ndërsa paditësi kërkon njohjen e pronësisë jo për te gjithë sipërfaqen por për atë prej ...m katrore.

Sipërfaqet e kërkuara për njohje te këtyre ngastrave paditësi me familje i ka ne posedim dhe shfrytëzim te pa penguar nga askush deri me sot te cilat evidentohen ne emër te paditurve dhe janë ne pronësi dhe posedim te tyre ne ... te tyre. Këto ngastra gjenden ne vendin e quajtur “T. P.-F.” ne ZK. Ll. e P.. Për këtë kane paguar çmimin kontraktues prej 11.000 dinar te asaj kohe ne kesh dore dhe menjëherë u, a kane dorëzuar paluajtshmerite ne posedim dhe shfrytëzim te pa penguar nga askush qe nga viti 1975.

Bartja e paluajtshmerisë nuk është bere për shkak te pengesave te ndryshme dhe e njëjta evidentohet ne emër te paditurve andaj paditësi ka interes juridik qe gjykata te vërtetoj se ai është pronar i ngastrës kadastrale.

Ne seanca, precizim te padisë dhe kërkesëpadisë si, dhe fjalën përfundimtare gjate shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbes pranë padisë dhe precizimit te kërkesëpadisë, deklarimit ne seanca dhe i propozoj gjykatës qe te aprovoj atë ne tersi si te bazuar dhe te vërtetohet se paditësi është pronar te këtyre ngastrave kadastrale sipas aktit te shitblerjes se paluajtshmerisë dhe posedimit me mirëbesim- parashkrim fitues qe nga viti 1975 e tutje dhe mbajtjes ne posedim me mirëbesim. Ngastrat kontestuese i punojnë, posedojnë dhe shfrytëzojnë te pa penguar nga askush prej momentit te shitblerjes se tyre deri me tani. Këtë e vërtetojnë dhe dëshmitaret e propozuar dhe te cilët do te dëgjohen ne seance V. S. dhe M. M. thënieve ne padi nga paditësi si dhe vet te autorizuarit te paditësit- djalit te tij A. M. te n dëgjuar gjate procedurës. lidhur me shitblerjen e

paluajtshmërisë objekt kontesti si dhe pagesa e bëra nga ana e paditësve –paraardhësve te tyre dhe te paditurit kesh ne dore si prova te cilat janë pjese e shkresave te lendes.

Në precizimin e padisë të datës 12.09.2024 i autorizuari i paditësit deklaroi se ai është i njëjti si ne petitum te padisë dhe me prova , me c’rast u vërtetu se paluajtshme rinë kontestuese ne baze te kontratës (marrëveshjes) për shitblerjen e paluajtshmerisë (Me veprim juridik) dhe këto ngastra paditësit i posedojnë me tepër se 45 vjet pandërprerë dhe penguar nga askush duke e konsideruar veten si pronar dhe mbi këtë baze te këtyre fakteve te paraqitura paditësit e kane fituar te drejtën e pronësisë me mirëbesim ne pajtim me dispozitat e nenit 28 par.2 dhe 4 lidhur me nenin 20 te LMTHPJ 1980.

Ne fjalën përfundimtare te dhënë ne shqyrtimin kryesor te datës 12.09.2024 ka deklaruar se: Pala paditëse ne ketë shqyrtim me prova te besueshme, dëshmi te dëshmitareve ka arritur te dëshmoj dhe vërtetoj se paditësit i kane blere këto paluajtshmerisë nga i padituri qe jenë objekt shqyrtimi para 45 vitesh.. Sipas dëgjimit te dëshmitareve është vërtetuar qarte se paditësit i kane blere ngastrat kadastrale kontestuese dhe e kane paguar. Çmimin kontraktues ne tersi, kane hyre ne posedim dhe shfrytëzim te tyre dhe i punojnë qe nga atëherë deri me te tre pa penguar nga askush.

Po ashtu gjate deklarimit te fjalës përfundimtare ka deklaruar se me administrimin e provave, dëgjimin e dëshmitareve dhe palëve ndergjygjese – paditësve u vërtetua baza juridike e padisë dhe kërkesëpadisë se paditësve ne tersi Këtë te drejte paditësit e kane fituar komform dispozitave te LMTHJP-se 1980, neni 28 al.1 dhe 2 te tij dhe LPDTS nenet 10, 36, 40.1, 104 dhe 115 e kane fituar te drejtën e pronësisë me mirëbesim. Ashtu qe gjykatës i propozoj qe padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta aprovoi ne tersi si te bazuar dhe te vërtetoj se te njëjtit janë pronare te paluajtshme rive te përshkruara ne petitumin e kërkesëpadisë.

Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoj pala paditëse, ndërsa për ato për përfaqësues të përkohshëm i bartë pala paditëse dhe te njëjtat i ka përmbushur.

Ne të përgjigju rit në padi te dt. 28.06.2024 dhe seancën e shqyrtimit kryesor të datës 10.07.2024 dhe dt.12.09.2024 përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurës av.E. M. ka deklaruar se: Ne parim e kundërshtojmë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit as precizimin e saj ne këtë faze te procedurës, si te pa mbështetur deri ne këtë faze pa prova materiale, duke u bazuar ne thëniet ne padi dhe propozimin për dëgjimin e dëshmitareve, ashtu qe gjykatës i propozon qe te refuzoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si te pa bazuar. dhe pa mbështetur ne prova konkrete. Etej ne seanca ka deklaruar se mbes pranë përgjigjes ne padi dhe thënieve ne seanca, pretendimeve dhe kundërshtimeve te mija te dhëna lidhur me këtë çështje civile- juridike dhe mbetet ne diskrecion te gjykatës qe te vendos për secilën prove dhe propozim te bere nga pala paditëse.

Kam pranuar përgjigjen e DKGJP ne Komunën e P. sipas kërkesës se gjykatës ku vërehet se nuk ka kurrfarë ndryshimi te pronareve ne këto ngastra qe nga vitet 1983 e tutje deri me sot por pas dëgjimit te dëshmitareve palëve dhe administrimit te provave rezervojmë te drejtën te deklarohemi ne fjalën përfundimtare dhe gjykatës i propozoj qe duke u bazuar ne prova te ofruara nga palët ndergjygjese te sjell një aktgjykim, përfundimtar dhe meritor ne këtë çështje kontrestimore duke u bazuar dhe ne dispozitat e LPK-se.

Ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se i propozoj gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e precizuar të paditësve ta aprovoj në tersi si të bazuar dhe paditësit të shpalle pronar të këtyre paluajtshme rive.

Shpenzimet i kërkoj por të cilat më janë përmbushur sipas TOAK-se.

Gjykata për të vërtetuar drejte gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore në procedurën e të provuarit bëri administrimin dhe leximin e këtyre provave:

Padia e dt. 13.12.2016, foto e vendit të ngjarjes, urgjencë e dt. 10.04.2019, pagesa e taksës gjyqësore e dt. 12.12.2016, verifikimi i faktit se është në jetë dhe adresa e dt.10.11.2020, kërkesë për sqarim dhe njoftim i dt. 11.12.2020, përgjigje e dt. 24.12.2020, përgjigje e dt. 02.06.2021 kërkesë për njoftim dhe sqarim e dt. 12.05.2022, përgjigja 16.08.2023, procesverbal i dt. 14.12.2023, procesverbal i dt. 25.03.2024, aktvendim për përfaqësues të përkohshëm me nr. ... i dt. 25.03.2024, aktvendim për përgjigje në padi me nr. C.nr. ... i dt. 25.03.2024, shpallja me nr. C.nr. ... i dt. 25.03.2024, përgjigje në padi me dt. 27.03.2024, „Publikimi në GZ. E d t. 29.03.2024, vërtetim nga N... B.. i dt. 05.04.2024, procesverbal i dt. 03.06.2024, aktvendim revokohet aktvendimi për caktimin e përfaqësuesit të paditurit H. P. dhe caktohet av. E. M. nga P. i dt. 10.06.2024 ,parashtrësia e dt. 25.06.2024. parashtrësia e dt. 29.06.2024. fatura për pagesën e shpenzimeve të avokatit e dt. 21.06.2024, publik në GZ e dt. 25.06.2024, përgjigje në padi e dt. 28.06.2024, aktvendim me nr. C.nr. ... i dt. 11.06.2024, procesverbal i dt. 10.07.2024, kërkesë Drejtorisë për pronë kadastrë dhe gjeodezi, e dt. 11.07.2024, kërkesë Drejtorisë për pronë kadastrë dhe gjeodezi, e dt. 26.07.2024.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e provave një nga një e të gjithave së bashku komform nenit 8 të LPK-së dhe duke pas parasysh se pala paditur – përfaqësuesi i përkohshëm i paditurës nuk e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, thëniet e palës paditëse në padi, precizim të kërkesëpadisë, përgjigje në padi dhe deklaratimit të përfaqësueses së përkohshme të paditurve në seancën e shqyrtimit kryesor, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në tersi dhe si të tillë e aprovoj siç është cekur dhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Në bazë të të dhënave mbi të drejtat e pronës se paluajtshme- certifikata e pronësisë për ngastrat kadastrale nr. ... dhe ... të dt. 19.07.2024 të siguruar nga ana e DKGJP ne P., përgjigjes se dhënë nga kjo drejtori në kërkesën e gjykatës për ndryshimet eventuale të pronareve në këto ngastra kadastrale të dt. 19.07.2024 dhe dt. 06.08.2024 nr. ... të dt. 26.07.2024, vërtetohet fakti se këto ngastra kadastrale kontestuese janë të evidentuara në emër të paditurive dhe atë: ngastra kad. nr. ... evidentohet në emër të paditurit P. (Xh.) K. dhe ngastra kad. nr. ... në emër të paditurit tjetër B. (M.) D. dhe kështu është gjendja e pa ndryshuar që nga vitet 1983 deri në ditën e përpilimit të kërkesës nga ana e DKGJP. Gjithashtu gjykata pas dëgjimit të dëshmitareve vërteton faktin se paditësi me familje i ka në posedim dhe shfrytëzim të pa penguar që nga vitit 1975 kur i ka blerë këto ngastra deri më sot i pa penguar nga askush.

Kjo rrethanë vërtetohet edhe nga deklarimi i palëve, thëniet në padi, si dhe skica kadastrale cila evidentohet në emër të paditurit.

Nga përgjigja dhëne gjykatës sipas kërkesës se saj te dt. 11.12.2020 prej A... te dt.24.12.2020, vërtetohet se kjo Agjenci ka te dhëna se ngastrat kadastrale nr. evidentohet ne emër te paditurit, mirëpo për pronat ne fjale nuk kane pranuar kurrfarë kërkesa dhe nuk kane mundur te identifikojnë ndonjë person fizik me emrat P. K. dhe B. D. te kenë parashtruar kërkesë apo ndonjë person tjetër fizik e juridik te këtë parashtruar kërkesë për pronat e lartpërmendura pranë Drejtorisë apo AKP –se.

Nga flete posedimi- certifikatat e pronësisë te lëshuara nga DKGJP ne P. te dt. 19.07.2024, te dt. 06.08.2024 për vitet e tanishme dhe ato te viteve 1983-88 dt. vërtetohet se ngastrat kad. nr. ... dhe ..., janë te evidentuara ne emër paditurve P. (Xh.) K. dhe te paditurit B.( P.) D..

Kontestues ishte fakti se a i ka blerë këtë paluajtshmëri paditësi dhe paraardhësit e tij, te cilën theksojnë se i kane blere nga te paditurit në vitin 1975 siç deklaroi pala paditëse dhe i autorizuar i tij në padi dhe seanca, si dhe fakti kontestues tjetër për gjykatën se a janë plotësuar kushtet ligjore për fitim të pronësisë në bazë të LMTHJP – së – 1980 neni 20 i tij dhe se a kane qenë paditësit posedues me mirëbesim apo jo.

Se paditësi se bashku me familjen e tij i kane blere këto ngastra kadastrale te cekurat me larte dhe qe kane hyrë në posedim dhe shfrytëzoi te tyre qe nga momenti i blerejs ne vitin 1975 e deri me sot dhe atë me mirëbesim në ngastrat kontestuese ku kane te ndërtuara dhe shtëpi dhe se të njëjtat i kane mbajtur e të cilën edhe tani i mbajnë paditësit me mirëbesim që nga viti 1975 konkretisht nga data kur është lidhur kontrata e shitblerjes se paluajtshmerise në vitin 1975, duke u kujdesur për të njëjtën për të veten dhe i pa penguar nga askush asnjëherë që nga ajo kohë e deri me sot, gjykata këtë fakt e vërtetoi nga dëgjimi i dëshmitareve te n dëgjuar ne seancën e shqyrtimit kryesor te dt 12.09.2024 dhe ate V. S. dhe M. M. nga L. e P. dhe kontrata private gojore e cila ishte e lidhur mes te palëve, ndërmjet paraardhësve te paditësve dhe vet Sh. si blerës ne njëren ane dhe atë te shitësve - te paditurve, në të cilën i kanë përcaktuar dhe kushtet e shitblerjes së ngastrave kontestuese si dhe mbi pagesat e bere te njëjtit, në të cilën vërtetohet dhe fakti se shitësve me këtë rast i,u është paguar dhe çmimi shitblerës në para të gatshme-kesh në dorë, ndërsa blerësi ka pranuar paluajtshme rinë në posedim faktik duke hyrë dhe mbajtur të njëjtën i pa penguar nga askush deri sot e kësaj dite.

Për të vërtetuar këtë fakt gjykata i mori parasysh deklaratimet e paditësit dhe te autorizuarit te tij në seancë të shqyrtimit kryesor ku ka deklaruar se i kane blerë këto paluajtshmeri paraardhesit e tyre babai im dhe gjyshi në vitin 1975, të hollat i,a kane paguar në tersi dhe e shfrytëzojmë tokën me tepër se 45 vite dhe e posedojmë atë edhe sot të pa penguar nga askush. Keto fakte i vërtetojnë dhe deklarojnë ne dëshminë e tyre dhe dëshmitaret V. S. dhe M. M. nga fshati Ll. e P. K. P., te cilët fakte i dëshmuuan ne seancën e shqyrtimit kryesor te dt. 12.09.2024.

Sipas ketyre dëshmimeve te dy (2) dëshmitare ne baze te cilave u dëshmuua dhe u vërtetu fakti se paditësi dhe babai i tij i kane blere paluajtshmerine nga te paditurit, u, a kane paguar çmimin kontraktues, dhe njeri prej tyre V. ka dijeni me shume për këtë dhe i ka njohur edhe dy te paditurit dhe te cilët kane qene dëshmitarë për këtë, ku i kane blere këto toka prej tyre dhe deri u, a kane paguar çmimin nuk u, a kane dorëzuar paluajtshmerine ne posedim dhe shfrytëzim, me te holla kesh ne dore, dhe pasi qe u, a kane paguar ata ju kane dorëzuar paluajtshmerite, si dhe te njëjtit i posedojnë , shfrytëzojnë këto paluajtshme ri te pa penguar nga askush deri me sot.

Njeri prej tyre V. S. kane qene dëshmitare okular e nuk e ka me te dëgjuar por ishte ne dijeni dhe prezent gjate tere procesit te shitblerjes se ketyre paluajtshmerive nga te paditurit.

Pas administrimit të këtyre provave gjykata gjeti se paditësit e kane fituar pronësinë mbi paluajtshmeritë të cilat gjenden në ZK. Ll. e P. K. P. në ngastrat kadastrale të cekur në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi në FP. Z.K.L. e P. por jo ne tere sipërfaqen e tyre vetëm një pjese te tyre te cekura ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe pjesërisht ju ka njohur vetëm ajo pjese e ngastrës e jo sipërfaqet e tera te tyre dhe te cilat nuk i ka kërkuar as paditësi dhe i autorizuari i tij, por vetëm pjesën te cilat i kane blere dhe te cilat i posedojnë dhe shfrytëzojnë. Andaj nëse i paraqiten probleme ne bartje te paluajtshmerive ne emër te tyre pala paditëse është njoftuar dhe ne seance dhe përfundim te saj se mund te angazhoj një gjeometër te licencuar dhe t,ia baj matjet e nevojshme ne teren dhe te përcaktoj sakt se cila dhe ku i bie ajo pjese e tokës, kufizimet dhe gjitha te dhënat e nevojshme dhe t'ia ofroj ato D.. se bashku me aktgjykim e ti mundësoj bartjen e tyre ne emër te paditësit. Qe nuk do te ishte fare problem kjo me u realizuar.

Këtë pronësi paditësit e kane fituar në bazë të kontratës së lidhur gojore mes të paraardhesve te paditësit dhe vet paditësit dhe të paditurve ne vitin 1975 dhe atë fitimin e pronësisë në bazë të posedimit të pandërprerë për më tepër se 45 vite me mirëbesim dhe posedim të ligjshëm si dhe me parashkrimin fitues. Duke iu referuar dispozitës ligjore te nenit 28 par.4 të ligjit- LMTHJP 1980 për paluajtshme ri nevojitet koha prej 20 vite në posedim të pa penguar nga askush dhe në rastin konkret kemi më tepër se 45 vite në shfrytëzim dhe posedim të paluajtshmerisë nga vet paditësit të pa penguar as nga i padituri, apo nga ndonjë person i tretë.

Bazuar ne nenin 20 te LMTHJP –se vitit 1980 e drejta e pronësisë fitohet sipas vete ligjit, ne baze te veprimit juridik dhe me trashëgimi”, ne rastin konkret paditësi e ka fituar te drejtën e pronësisë me veprim juridik- kontratën gojore te shitblerjes se paluajtshmerive te lidhur me te paditurit ne vitin 1975.

Kjo mënyrë e fitimit të pronësisë në bazë të kontratës të shitblerjes së paluajtshmerisë e cila kontratë ishte lidhur ne vitin 1975 është e paraparë dhe në pajtim me dispozitat e LMD–së së vitit 1978 neni 26, 28, 29, 31, 46 dhe 51 ku palët kanë lidhur kontratë të shitblerjes së paluajtshmerive mes veti pa pasur kanosje, lajthim esencial apo mashtrim sipas nenit 60, 61 dhe 65 të LMD–së vitit 1978. Mirëpo edhe pse nuk është e lidhur kjo kontratë në formën e paraparë ligjore sipas dispozitave te LMTHPJ së vitit 1980. Kjo kontratë është po ashtu dhe në pajtim me dispozitën ligjore komform nenit 73 të LMD–së së vitit 1978. E njëjta është e plotfuqishme dhe bëhet konvalidimi i saj, pasi që sipas nenit të cekur palët kontraktuese – ndërgjygjëse i kanë zbatuar në tersi detyrimet që dalin nga kontrata e lidhur mes tyre ndaj njëra tjetrës. Se paditësi e ka paguar në tersi çmimin kontraktues dhe i padituri ia ka dorëzuar atij në posedim dhe shfrytëzim të përhershëm dhe paditësi e posedon dhe i shfrytëzon këtë paluajtshmeri sot e kësaj dite i pa penguar nga askush.

Paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë dhe në pajtim me dispozitat e LMTHJP së vitit 1980 dhe LPDS së vitit 2009 Ligji nr.03/L-154 në nenin 20 par.1 të LMTHJP ku thuhet: “E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim”. Paditësi pronësinë mbi këtë paluajtshmeri pikërisht e ka fituar në bazë të veprimit juridik – kontratës

joformale, pagesa e bërë e çmimit kontraktues dhe hyrja në posedim dhe shfrytëzim të paluajtshmërisë, të cilën e punojnë që nga viti 1975 kur i ka blerë paditësi së bashku me familjen e tij nga te paditurit dhe deri më sot pa pengesa nga askush e posedon dhe e shfrytëzon atë. Kjo mënyrë e fitimit të pronësisë nga paditësit gjen mbështetje dhe në dispozitën ligjore të nenit 20 të LMTHJP par. 1. Ketë paluajtshmeri paditësit me familje e kane mbajtur me mirëbesim ne posedim te papenguar nga askush deri ditën e sotme qe nga momenti i blerjes dhe te njëjtit janë ne posedim te ligjshëm.

Po ashtu paditësit këtë paluajtshmeri e kane në posedim të ligjshëm dhe e mbajnë me mirëbesim atë edhe sot për më shumë se 45 vite dhe sipas nenit 72 par. 1 dhe 2 të LMTHPJ 1980. Edhe sikur të mos kishin bazë tjetër të fitimit të pronësisë paditësi e ka fituar pronësinë mbi këtë paluajtshmeri edhe në bazë të parashkrimit fitues të paraparë me dispozitën e nenit 28 par.2 dhe 4 të LMTHPJ 1980. Ky fitim i pronësisë është i rregulluar dhe me nenin 36 dhe 40 të LPDS 03/1-154 2009.

E drejta e pronësisë është e rregulluar, garantuar dhe mbrohet me Kushtetutën e R. Kosovës në nenin 46.1 të saj dhe me Konventën Evropiane e të Drejtave të Njeriut në pjesën e Protokollit shtojcë të Konventës së Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore neni 1.1 i saj ku thuhet se: "Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën që ti respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare".

Andaj gjykata me zbatim të dispozitave të lartcekura dhe mbi bazën juridike të pa kontestuar nga përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurës ua njohu të drejtën e pronësisë paditësve në këto paluajtshmeri. Ky aktgjykim mund ti shërbej D... në P. që ti bëjë ndryshimet e nevojshme dhe ta regjistroj paluajtshmerinë nga të paditurit në emër të paditësve në librat kadastral siç është cekur dhe në dispozitiv të këtij aktgjykim

Andaj me prova materiale në mënyrë të pa dyshimtë u vërtetua se paditësi i ka blerë me babain e tij paluajtshmeritë nga te paditurit, u, a ka paguar çmimin kontraktues, kanë hyrë në posedim dhe shfrytëzim të pa penguar nga askush që nga viti 1975 kur janë blerë këto paluajtshmeri dhe nuk i ka penguar askush tjetër andaj mbi këtë bazë e kane fituar të drejtën e pronësisë. Kjo dëshmohet me deklaratimet e palës paditëse si ne padi, precizim te saj ashtu edhe ne seanca gjyqësore, deklaratimet e dëshmitareve ne seancën e shqyrtimit kryesor te dt. 12.09.2024,dhe pagesa e bere e çmimit kontraktues sipas dëshmitareve dhe vet paditësve, mos kundërshtimi i përfaqësuesit te përkohshëm te padisë dhe kërkesëpadisë ne seancën e shqyrtimit kryesor si dhe provave tjera në shkresat e lëndës.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata vendosi që ato për përfaqësuesin e përkohshëm ti bartë pala paditëse dhe ato i ka kryer me kohë pala paditëse për shpenzimet e përfaqësuesit të përkohshëm kurse shpenzimet tjera i bartin secila palë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore në pajtim me dispozitat e nenit 450 LPK-së dhe UA 01/2017 të KGJK-së për unifikim të taksës gjyqësore.

Vendimin lidhur me detyrimin qe paditësit te bëjnë pagesën e taksës gjyqësore shtese ne mënyre solidare,. për padinë e ushtruar ne gjykate, u mor komform dispozitave te nenit 253.1 dhe 4 te

LPK-se, si dhe nenit 12.1 te UA 01/2017 te KGJK-se, për unifikimin e taksave gjyqësore, duke detyruar paditësit qe ne emër te taksës gjyqësore shtesë për padi te paguajnë ne mënyre solidare shumen prej 45.00 euro, ne baze te vlerës se kërkesëpadisë se saktësuar me parashtresën mbi precizimin e kërkesepadise, meqë gjykata nuk ka dëshmi se është paguar nga paditësit, ngase me rastin e dorëzimit te padisë ne gjykate është paguar vetëm taksa gjyqësore ne shumen prej 15.00 euro.

Nga të thënat e mësipërme më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – DEGA PODUJEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**  
**C.nr.533/16 datë 18.09.2024**

**Gjyqtari**  
**Binak Duqi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.